

# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10128, DATË 11.5.2009, ‘PËR TREGTINË ELEKTRONIKE’, TË NDRYSHUAR”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e tregtisë elektronike, të tregut të brendshëm dhe të mosdiskriminimit në transaksionet ndërkufitare, nëpërmjet disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 10 128, datë 11.5.2009, “*Për tregtinë elektronike*”, të ndryshuar.

Në mënyrë të posaçme, projektligji synon të përfshijë në kuadrin ligjor vendas rregulla të qarta për ndalimin e gjeoblokimit të pajustificuar dhe të formave të tjera të diskriminimit ndaj klientëve për shkak të shtetësisë, vendbanimit ose vendit të themelimit të tyre, në rastet kur këto praktika shfaqen në mjedisin e tregtisë elektronike dhe të ofrimit të shërbimeve në rrugë elektronike.

Po kështu, projektligji synon të krijojë një bazë ligjore fillestare për trajtimin e tregjeve digjitale dhe të ndërmarrjeve që ushtrojnë rol të rëndësishëm ndërmjetësues në to, në funksion të përafrimit gradual me zhvillimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen me këtë projektligj janë:

- a) forcimi i mbrojtjes së konsumatorëve dhe i përdoruesve fundorë në transaksionet elektronike;
- b) ndalimi i praktikave diskriminuese të pajustificuara në aksesin në ndërfaqet online, në mallra, në shërbime dhe në pagesa;
- c) rritja e sigurisë juridike për tregtarët, konsumatorët dhe autoritetet zbatuese;
- d) përmirësimi i funksionimit të tregtisë elektronike dhe lehtësimi i transaksioneve ndërkufitare;
- e) krijimi i një baze ligjore për trajtimin e tregjeve digjitale.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji është në përputhje me orientimin e përgjithshëm të politikave shtetërore për afrimin progresiv të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e tregut të brendshëm, tregtisë elektronike, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit të ekonomisë digjitale.

Ai i shërben forcimit të kuadrit rregullator vendas në një fushë që ka marrë rëndësi të shtuar në praktikën tregtare dhe në marrëdhëniet juridike ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, duke pasur parasysh zgjerimin e përdorimit të platformave online, të ndërfaqeve elektronike dhe të shërbimeve të pagesave në transaksionet e përditshme.

Nga pikëpamja e teknikës legjislative, ndërhyrja në ligjin ekzistues “*Për tregtinë elektronike*” paraqitet si zgjidhje e arsyeshme, pasi ky ligj përbën aktin bazë që rregullon veprimtaritë tregtare të kryera në rrugë elektronike. Përfshirja në të e dispozitave për gjeobllokimin e pajustificuar dhe e dispozitave bazë për tregjet digjitale garanton koherencë sistematike, shmang fragmentimin e panevojshëm të rregullimit dhe lehtëson zbatimin praktik të tyre.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Nevoja për këtë projektligj buron nga domosdoshmëria për të adresuar në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë praktikatat e gjeobllokimit të pajustificuar dhe format e tjera të diskriminimit që shfaqen në tregtinë elektronike, në veçanti kur klientëve u mohohet ose u kufizohet aksesit në ndërfaqe online, u imponohen kushte të ndryshme aksesit në mallra ose shërbime, ose trajtohen ndryshe për sa u përket mënyrave dhe kushteve të pagesës.

Këto praktika cenojnë funksionimin normal të tregut, kufizojnë zgjedhjen e konsumatorëve, pengojnë transaksionet ndërkufitare dhe krijojnë pasiguri juridike për të gjithë pjesëmarrësit në treg. Për këtë arsye, është e nevojshme që legjislacioni shqiptar të përmbajë dispozita të posaçme, të qarta dhe të zbatueshme, të cilat të ndalojnë trajtimin e ndryshëm kur ai nuk mbështetet në një justifikim objektiv ligjor.

Një nga përparësitë themelore të projektligjit është se ai nuk vendos mbi tregtarët një detyrim të përgjithshëm për të ofruar mallra ose shërbime në çdo territor apo për të organizuar dërgesa ndërkufitare në çdo rast. Projektligji synon vetëm të ndalojë

trajtimin e ndryshëm të pajustificuar në situatat e përcaktuara shprehimisht në ligj. Në këtë mënyrë ruhet ekuilibri ndërmjet mbrojtjes së klientit dhe lirisë së ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

Efektet e pritshme të projektligjit janë:

- a) rritja e transparencës dhe e parashikueshmërisë në tregtinë elektronike;
- b) zgjerimi i mundësive të klientëve për të hyrë në oferta ndërkufitare në kushte jodiskriminuese;
- c) ulja e praktikave diskriminuese në mjedisin digjital;
- d) forcimi i mbrojtjes së konsumatorit;
- e) qartësimi i kuadrit institucional për zbatimin e rregullave në fushën e gjeoblokimit dhe të tregjeve digjitale.

Për më tepër, përfshirja në ligj e dispozitave bazë për tregjet digjitale dhe për “gatekeeper”-ët vendos një bazë fillestare për trajtimin e kësaj fushe në të drejtën shqiptare dhe për përafrimin e mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDËS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me parimet themelore të shtetit të së drejtës, të lirisë së veprimtarisë ekonomike, të mbrojtjes së konsumatorit dhe të proporcionalitetit.

Përmbajtja e tij nuk cenon autonominë private apo lirinë kontraktore, por vendos kufij të arsyeshëm kundër praktikave diskriminuese në tregtinë elektronike, vetëm për atë sa këto praktika nuk justifikohen objektivisht.

Projektligji harmonizohet me legjislacionin vendas në fuqi, veçanërisht me:

- a) ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) legjislacionin në fuqi për shërbimet;
- c) legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave;
- d) legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës;
- e) legjislacionin në fuqi në fushën e së drejtës ndërkombëtare private.

Njëkohësisht, projektligji parashikon qartë se dispozitat për gjeoblokimin zbatohen pa cenuar legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet, të drejtat e autorit dhe juridiksionin gjyqësor në çështjet civile, duke respektuar ndarjen materiale të fushave të rregullimit.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Projektligji synon përafrimin e legjislacionit shqiptar, në radhë të parë, me Rregulloren (BE) 2018/302 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 28 shkurt 2018, mbi adresimin e gjeobllokimit të pajustificuar dhe formave të tjera të diskriminimit bazuar në shtetësinë e konsumatorëve, vendbanimin ose vendin e themelimit të klientëve brenda tregut të brendshëm.

Miratimi i normave rregulluese të gjeobllokimit është edhe një nga kushtet e pozicionit negociues për mbylljen e Kapitullit 10 “Transformimi digjital dhe media”.

Dispozitat e projektligjit reflektojnë në mënyrë thelbësore strukturën materiale të kësaj rregulloreje, veçanërisht në lidhje me:

- a) përkufizimet bazë;
- b) fushën e zbatimit;
- c) aksesin në ndërfaqet online;
- d) aksesin në mallra ose shërbime;
- e) mosdiskriminimin për arsye që lidhen me pagesat;
- f) pavlefshmërinë e marrëveshjeve që kufizojnë shitjet pasive në kundërshtim me ligjin.

Projektligji përmban gjithashtu dispozita bazë në lidhje me tregjet digjitale dhe “gatekeeper”-ët, duke marrë në konsideratë zhvillimet e acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe duke krijuar bazën ligjore për rregullimin e mëtejshëm të tyre në të drejtën shqiptare.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009, “Për tregtinë elektronike”, të ndryshuar.

Me nenin 1, propozohet të ndryshohet neni 1, i ligjit nr. 10128/2009, duke përcaktuar më qartë objektin dhe qëllimin e tij. Krahas rregullave për tregtinë elektronike, në ligj përfshihen shprehimisht edhe rregullat për trajtimin e gjeobllokimit të pajustificuar dhe baza ligjore për mirëfunksionimin e tregjeve digjitale.

Me nenin 2, shtohen përkufizime të reja në nenin 3 të ligjit nr. 10128/2009. Këto përkufizime lidhen me terminologjinë e nevojshme për zbatimin e dispozitave për gjeobllokimin dhe tregjet digjitale, si: shërbime të ofruara elektronikisht, klient,

kushte të përgjithshme aksesit, ndërfaqe online, tregtar, instrument pagese, llogari pagese, gatekeeper, shërbim thelbësor i platformës, tregje digjitale dhe shtet anëtar.

Me nenin 3, propozohet një shtesë në gjurmën d, të nenit 12, që parashikon harmonizimin me rregullimet që shtohen me riformulimin e Kreut V, që rregullon “Gjeobllokimin e pajustificuar”.

Me nenin 4, propozohet të ndryshohet Kreu V, që rregullon “Gjeobllokimin e pajustificuar”. Ky propozim vjen i harmonizuar me faktin që nenet e përfshira në kreun V, ekzistues janë shfuqizuar nga Direktiva 2000/31/EC, dhe janë integruar në Rregulloren e re të BE-së për Aktin e Shërbimit Digjital me rregullime më të plotësuar.

Në këtë kre, janë përfshirë nenet si më poshtë:

- neni 15, i cili përcakton fushën e zbatimit të Kreut V. Në këtë dispozitë saktësohen objektet material të rregullimit, përjashtimi i situatave thjesht të brendshme, raporti me legjislacionin për shërbimet, taksat, të drejtat e autorit dhe juridiksionin në çështjet civile, si dhe parimi se respektimi i këtyre rregullave nuk nënkupton, në vetvete, drejtimin e veprimtarisë së tregtarit drejt shtetit të konsumatorit.
- neni 16, i cili rregullon aksesin në ndërfaqet online. Parashikohet ndalimi i bllokimit ose kufizimit të aksesit të klientit në ndërfaqen online, si dhe ndalimi i ridrejtitimit pa pëlqimin e shprehur të klientit, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për respektimin e një kërkesë ligjore të zbatueshme.
- neni 17, i cili rregullon aksesin në mallra ose shërbime. Kjo dispozitë përcakton rastet në të cilat tregtari nuk mund të zbatojë kushte të ndryshme të përgjithshme aksesit për arsye që lidhen me shtetësinë, vendbanimin ose vendin e themelimit të klientit.
- neni 18, duke sqaruar përjashtimin e posaçëm në lidhje me çmimet e librave, kur një trajtim i tillë lejohet ose kërkohet nga legjislacioni i zbatueshëm.
- neni 19, i cili rregullon mosdiskriminimin për arsye që lidhen me pagesat. Kjo dispozitë ndalon vendosjen e kushteve të ndryshme të pagesës për arsye që lidhen me identitetin territorial të klientit ose me elementet territoriale të instrumentit apo shërbimit të pagesës, kur plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara.
- neni 20, që trajton marrëveshjet që kufizojnë shitjet pasive. Parashikohet shprehimisht pavlefshmëria e dispozitave kontraktore që imponojnë tregtarit të veprojë në kundërshtim me ndalimet e parashikuara në Kreun V.

Me nenin 5, propozohet një ndryshim në nenin 21, duke përcaktuar autoritetet kompetente për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve të ligjit. Për dispozitat që lidhen me gjeobllokimin ngarkohen autoritetet kompetente sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, ndërsa për dispozitat që lidhen me tregjet digjitale ngarkohet Autoriteti i Konkurrencës.

Me nenin 6, shtohet pika 3 në nenin 21/1, duke përcaktuar pikat e kontaktit ZAM si strukturat që ofrojnë ndihmë praktike për konsumatorët në rast mosmarrëveshjeje me tregtarin, në lidhje me zbatimin e dispozitave të Kreut V.

Me nenin 7, propozohet ndryshim në nenin 22, duke përfshirë në mënyrë të qartë shkeljet që lidhen me mosrespektimin e neneve 15–19 për gjeobllokimin e pajustificuar.

Me dispozitën e fundit tranzitore neni 8, parashikohet se, në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, një pjesë e dispozitave të reja të ligjit shfuqizohen, ndërsa dispozitat për autoritetet kompetente dhe sanksionet administrative që lidhen me Kreun V mbeten në fuqi.

Me nenin 9, parashikohet hyrja në fuqi e ligji, 15 dite nga botimi në fletoren zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë:

- a) autoritetet kompetente të përcaktuara sipas ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, sipas fushave të tyre të kompetencës, për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që lidhen me gjeobllokimin e pajustificuar;
- b) autoriteti kompetent i mbrojtjes së konsumatorëve, i cili mban përgjegjësinë kryesore dhe koordinuese për këtë pjesë të ligjit;
- c) pikat e kontaktit ZAM, për ndihmën praktike ndaj konsumatorëve në rast mosmarrëveshjeje me tregtarin;

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën, si dhe strukturat përgjegjëse për përafrimin e legjislacionit në fushën e tregut të brendshëm, tregtisë elektronike dhe mbrojtjes së konsumatorit, në konsultim me institucionet publike kompetente në fushën e tregtisë elektronike, mbrojtjes së konsumatorit, pagesave, konkurrencës dhe shërbimeve digjitale, me ndihmën dhe mbështetjen e

projektit të GIZ mbi “*Enhancing Trade for Regional Economic Development in the Western Balkans (RegioTrade)*”.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji, nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, për aq kohë sa zbatimi i tij i ngarkohet kryesisht strukturave ekzistuese institucionale.

Efektet kryesore financiare dhe administrative pritet të lidhen me:

- a) përditësimin e kuadrit nënligjor;
- b) aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese ndaj tregtarëve dhe konsumatorëve;
- c) përshtatjen e procedurave administrative dhe të bashkëpunimit institucional;
- d) mundësinë e forcimit të kapaciteteve administrative të autoriteteve përgjegjëse, nëse kjo vlerësohet e nevojshme në fazën e zbatimit.

Megjithatë, përfitimet e pritshme nga rritja e transparencës, përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit, reduktimi i praktikave diskriminuese dhe lehtësimi i transaksioneve ndërkufitare tejkalojnë kostot e mundshme administrative që mund të lindin nga zbatimi i këtij projektligji.

**MINISTRI**

**Enea Karakaçi**